

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
L U S H N J E**

V E N D I M
NR. 69 DATE 31.07.07

**PER MIRATIMIN E GJOBAVE PER SUBJEKTET PER
ZENIEN DHE DEMTIMIN E TROTUAREVE DHE HAPESIRAVE
PUBLIKE**

Keshilli Bashkiak Lushnje ne mbledhjen e tij te dates 31.07.2007 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikes, Drejtoria e Sherbimeve, Policia Bashkiake, Drejtoria e Tatim Taksave dhe Drejtoria Juridike duke u mbeshtetur ne Ligjin Nr. 8652 date 31.07.2000“ Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “, pika k neni 32 , neni 57 paragrafi i fundit i ligjit Nr. 8405 date 17.09.1998 “ Per urbanistiken “ si dhe neni 9 te Ligjit Nr. 8224 date 15.05.1997 “ Per organizimin dhe funksionimin e Policise Bashkiake,

V E N D O S I :

Te miratoje :

1.- Subjektet qe kane zene ne menyre ta paligjshme hapesirat publike si ndertimet ne trotuare, vodosje çadrash, apo tendash ne trotuare qe jane te pa licensuara nga ana e tatim taksave te Bashkise si dhe per çdo rast tjeter, rastet e prishjes se kanalizimeve KUZ si dhe punime qe kryejne neper rruge pa mare me pare miratimin nga institucion i Bashkise do te gjobiten 50000 deri ne 100000 leke, dhe kthimin e tyre ne gjendje te meparshme nga ana e personave per gjegjes juridik dhe fizik.

2.-Per firmat ndertuese si dhe personat privat qe ushtrojne aktivitetin ne njesite administrative Bashkia Lushnje qe hedhin materialet inerte te ngurta ne vendet e pa miratuara nga Bashkia per rastet qe do konstatohen do te gjobiten 50000 deri ne 100000 leke per çdo rast.

3.-Per firmat ndertuese qe ushtrojne aktivitetin ne njesine administrative Bashkia Lushnje qe nuk kane nenshkruar deklaraten per

marrjen e masave te sigurimit teknik ne baze te nenit 57 te Ligjit Nr. 8405 date 17.09.1998 " Per urbanistiken " si dhe per te gjithe lejet e tjera te ndertimit qe do te jepen ne vazhdimesi nga ana e Bashkise Lushnje per marrje te masave te sigurimit teknik nga firmat sipermarse do te gjobiten 50000 deri ne 100000 leke, per çdo rast.

4.-Ne rast se subjekti (sipermares privat, riparues si KESH, PTT, Ujesjelles kanalizime si dhe qytetare) kur është i paisur me leje nga institucion i Bashkise ne perfundim te plote te punimeve sipas projektit jane te detyruar qe te kthejne ne gjendjen e meparshme pronen publike, rrugen , trrotuaret, lulishtet. Ne qofte se brenda 3 diteve pas perfundimit te punimeve nuk ka kthyer ne gjendjen e meparshme pronen publike do te gjobitet 50000 deri ne 100000 leke.

5.-Per njohjen sa me te plote te ketij vendimi do te behet publikimi ne mediat lokale televizive : nepermjet dergimit zyrtar te ketij vendimi tek te gjithe personat fizike dhe juridike qe jane te rregjistruar ne Drejtorine e Tatim Taksave ne Bashkine Lushnje si dhe Drejtoria e Marredhenieve me Publikun.

6.-Subjektet qe jane konstatuar nga Drejtorite perkatese ne Bashki kane te drejten e ankimimit prane Kryetarit te Bashkise me shkrim duke paraqitur arsyet dhe dokumentacion perkates qe mund te kene. Kryetari i Bashkise pasi degjon palet e demtuara brenda 30 diteve ka te drejte qe te konkludoje dhe te jape mendimin perfundimtar per gjaben. Konkluzioni i dhene nga Kryetari i Bashkise është i formes se prere.

7.-Te ardhurat qe do realizohen nga gjobat do te derdhen ne buxhetin e Bashkise dhe do te investohen per mbajtjen e trotuareve, hapesirave te gjelberta dhe mbjelljen e pemeve.

8.-Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Policia Bashkiake, Drejtoria e Urbanistikes, Drejtoria e Sherbimeve, Drejtoria e Tatim Taksave dhe Drejtoria Juridike .

9.-Vendimi Nr. 30 date 29.04.2004 i Keshillit Bashkiak çfuqizohet.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK
VASILIKAHOXHA

